



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 283, datë 10.12.2019

PËR
SKUALIFIKIMIN E KANDIDATES JOGJYQTARE ZNJ. {...} DHE PËRJASHTIMIN E
SAJ NGA KANDIDIMI PËR EMËRIM SI GJYQTARE NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 10.12.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatën znj {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin e kandidatës jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me Vendimi nr.108, Vendim nr.109 datë 09.07.2019, si dhe Vendim nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :

- I. *Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative.*
- II. *Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor*

1.1 Me Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr.

98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :

- I. *Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.*
- II. *Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor*

1.2 Me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :

- I. *Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile*
- II. *Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor*

2. Brenda afatit dyjavor nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për tre pozicionet e lira të shpallura përmes vendimeve me sipër, ka aplikuar për të marrë pjesë edhe kandidatja znj. {...}.

3. Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :

1. *Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.*
2. *Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, si më poshtë: Omissis...;*
4. *Për znj. {...} - relator z.Alban Toro ...”.*

4. Më datë 26.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua : - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidatja znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrori asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 30.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion nuk ishte i plotë (mungonte dokumenti që vërteton mosqenien i dënuar me vendim penal të formës së prerë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, Certifikata personale që vërteton shtetësinë shqiptare në momentin e aplikimit; vetë deklarimi për mos mbajtjen e funksioneve politike në administratën publike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit; vetë deklarimi për mos mbajtjen e pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit; vetë deklarimi për mosqenien i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe për mospasjen masë disiplinore në fuqi; vetë deklarimi për mosqenien anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; vetë deklarimi për mosqenien bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.), kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. Më datë 29.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesë ditor, kandidatja znj. {...}, depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, ndërsa brenda datës 06.09.2019 të caktuar me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 06.08.2019 dhe 07.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për znj. {...}.

10. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

11. Më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, atij “të pasjes gradë shkencore në drejtësi”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me Shkresën nr. 4163 prot., u kërkua informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin

e gradës shkencore në drejtësi nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër ta edhe për znj. {...}.

12. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar informacionin dhe konfirmimin përkatës, ndër të tjerë edhe për kandidaten znj. {...}, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4163/1 prot., datë 26.08.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

13. Po më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, por edhe të kriterit “të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, neni 49 në lidhje me shkronjën “dh” të nenit 28, të Ligjit të Statusit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet shtetërore dhe private që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatës znj. {...}, subjekte të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

14. Në kuadër të verifikimit të kushtit dhe kriterit të kandidimit si më lart (sipas pikës 13), më datë 06.08.2019, u kërkua informacion në lidhje me punësimin e kandidatëve, ndër ta edhe për znj. {...}, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

15. Më datë 30.08.2019, me qëllim verifikimin e kushtit të kandidimit “të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, përmes shkresave të veçanta u kërkua informacion dhe dokumentacion për kandidatët, ndër ta edhe për znj. {...}, nga disa parti politike kryesore në vend. Këto të fundit kanë përcjellë informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

16. Po në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit si më lart (sipas pikës 15), më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga Gjykata në regjistrin e organizatave jofitimprurëse. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sa i përket kandidatës znj. {...} ka përcjellë informacionin e saj më datë 28.10.2019, siç do të përshkruhet më poshtë.

17. Në vijim të verifikimit, në lidhje me kriterin e pasjes së zotësisë për të vepruar, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga gjykata e vendbanimit të kandidatit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka përcjellë informacionin e saj më datë 25.10.2019, siç do të përshkruhet më poshtë.

18. Në vijim të verifikimit, në lidhje me kriterin e pasjes së zotësisë për të vepruar, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, më datë

25.10.2019, u kërkua informacion nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, e cila ka përcjell informacionin e saj më datë 30.10.2019, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË

1. Kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 136, pikat 3 dhe 4. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “3. *Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi. 4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”.*

2. Gjithashtu kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, janë përcaktuar edhe në Ligjin e Statusit, nenin 49 (“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”), pikat 1 dhe 2, shkronja “b”. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “1. *Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. 2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.*

3. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikuan këto kushte kandidimi/emërimi:

a) qenia jurist.

a.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar (të njëzuar me origjinalin) dokumentin Diplomë nr. 348, me nr. regjistri 8728, nga Universiteti Luigj Gurakuqi, sipas të cilit kandidatja {...}, në periudhën 1999-2003, ka kryer kursin e plotë të Fakultetit të Drejtësisë Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër në Degën “Drejtësi” dhe me vendim të komisionit shtetëror të datës 05.07.2003 i është dhënë titulli “Jurist”. Bashkëngjitur Diplomës është dhe dokumenti (i njëzuar me origjinalin) “Lista e Rezultateve të Provimeve”, lëshuar më datë 05.07.2003, nga Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër, Fakulteti i Drejtësisë.

b) përvoja profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

b.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, sipas të cilit kandidatja ka përvojë profesionale si lektore e së drejtës dhe juriste e nivelit të lartë në administratën publike. Konkretisht, në mënyrë kronologjike, përvoja profesionale e kandidates sipas dokumentit “Librezë Pune” është si vijon:

“Juriste” në KESH sh.a e Divizionit Shkodër, për periudhën 15.03.2004 - 05.12.2008;
“Pedagoge” në Universitetin Jopublik “Kristal”, për periudhën 01.11.2019 - 30.09.2013;
“Përgjegjëse departamenti” në Universitetin Jopublik “Kristal”, për periudhën 01.10.2013 - 15.09.2014;
“Specialiste” në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për periudhën 06.01.2016 -01.02.2018;
“Këshilltare Ligjore” në Institucionin e Komisionerëve Publik, për periudhën 01.02.2018 pa datë mbyllje.

b.2 Gjatë verifikimit, referuar subjekteve ku kandidatja figuronte të kishte qenë e punësuar sipas dokumentit “Librezë Pune”, prej tyre u kërkua informacion për të dhënat e punësimit të kandidatës. Konkretisht:

me Shkresën nr. 20755/7 prot., datë 3872/20, OSHEE informon se kandidatja “*ka kryer detyrën e juristes pranë KESH Shkodër , për periudhën 15.03.2004 – 05.12.2008 periudhe e cila ka disa ndërprerje për arsye të dy leje lindjeve të njëpasnjëshme¹ ”;*

me Shkresën nr. 2752/1 prot., datë 22.08.2019, Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër informon se kandidatja “*ka punuar pranë Universitetit Luigj Gurakuqi Shkodër në pozicionin e pedagoges me kohë të pjesshme për periudhat 2003-2004 dhe 2004-2005 referuar kurseve sipas viteve akademike të sipër cituar;*

me Shkresën nr. 1221/1 prot., datë 28.08.2019, Universiteti i Politeknik i Tiranës informon se kandidatja “*nuk ka punuar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës gjë e cila është deklaruar nga kandidatja në dokumentacionin e paraqitur prej saj në kërkesën për konkurrim datë 17.07.2019”;*

me Shkresën, datë 14.08.2019, Shoqëria Intersig Sh.a informon se kandidatja “*ka qenë angazhuar pranë shoqërisë së sigurimit Intersig sh.a për një periudhë kohore njëvjeçare duke filluar nga fillimi i vitit 2003-deri në vitin 2004 si këshilluese dhe asistente ligjore”;*

me Shkresën nr. 20340/1 prot., datë 15.08.2019, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ” informon se kandidatja “*ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nga periudha 24.12.2015 dhe është larguar me dëshirën e saj nga DPD më datë 01.02.2018”*

me Shkresën, nr. 8 prot., datë 14.08.2019, Shoqëria Albamedia Sh.p.k informon se kandidatja “*ka qenë angazhuar pranë shoqërisë Albamedia Sh.p.k për një periudhë kohore duke filluar nga 2014-2015 si këshilluese dhe asistente ligjore”;*

me Shkresën nr. 433/1 prot., datë 09.08.2019, Institucioni i Komisionerëve Publikë” informon se kandidatja “*ka është e punësuar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë nga periudha 01.02.2017 me detyrë Këshilltare Ligjore në njësinë e shërbimit ligjor të këtij institucioni”.*

¹ Referuar ligjit Nr.7703, datë 11.5.1993 Për Sigurimet Shoqërore Në Republikën E Shqipërisë - Neni 27 - **E ardhura për barrë lindje** (Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 3) - “ *1. E ardhura për barrë lindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfshihet nga ky rregull rasti kur gjatë periudhës së përfitimit të barrë lindjes gruaja ka kushte për një përfitim të ri barrë lindjeje”.*

b.3 Po ashtu, gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Konkretisht:

me Shkresën nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndër të tjera, informon se *“Për shtetasen {...} rezulton të ketë qenë administratore e subjektit “{...}” me Nipt.L06529006B i cili është çregjistruar që në datë 20.01.2014 ...për efekt burim të ardhura nga paga, rezulton të ketë punuar ose/dhe punon pranë subjektit: 1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave – Specialist i Lartë 2. Kristal - Pedagoge” 3. {...}– Sipërmarrëse, 4.Komisionerët Publikë – Këshilltare Ligjore.* Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar dhe një kopje-historiku i punësimit sipas ESIG027, kopje-ekstrakti historik i punonjësit, me të gjithë të dhënat shifrore të pagës, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, kontributet përkatëse dhe TAP për çdo muaj, vit dhe subjekt/institucion punëdhënës, në të cilin ka punuar dhe/ose punon kandidatja. Në historikun e punësimit sipas ESIG027 pasqyrohet punësimi i kandidatit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave gjatë periudhës 2015-2018, në “Kristal” për periudhën Dhjetor 2011-2014, në Komisionerët Publikë për periudhën 2018 e në vijim. Ndërsa në ekstraktin historik të punonjësit pasqyrohet punësimi i kandidatës në “{...}” për periudhën Dhjetor 2012 deri më 20.01.2014 ku dhe është statusi i Çregjistruar.

me Shkresën nr. 5744/1 prot., datë 09.08.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon për të dhëna punësimi të kandidatës për periudhën 2012 e në vijim, referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi informatikë i saj, që dispononte të dhëna për kontributet që mblihdeshin dhe dërgoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Web Service, të dhëna këto që disponoheshin nga viti 2012 dhe në vijim. Sipas të dhënave të dërguara përmes kësaj shkrese, jepen të njëjta të dhëna punësimi të kandidatit sikundër ato të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si më lart;

me Shkresën nr. 8468 prot., datë 19.09.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, informon për të dhënat e punësimit të kandidatës për periudhën 2004² - 2012, si vijon: si i punësuar “KESH sh.a” për periudhat Mars 2004 - Nëntor 2018 (me një periudhë kohore pa kontribute prej 19 muaj) dhe Janar 2008 - Dhjetor 2012; si i punësuar në Universitetin Kristal. Në lidhje me subjektet Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër dhe Shoqërisë së Sigurimeve Intersig sh.a i jemi drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, konkretisht, Drejtorisë Rajonale Shkodër.

me Shkresë nr.5133/1 datë 07.10.2019 Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Shkodër informon se për subjektin Luigj Gurakuqi ku kandidatja ka qenë pedagoge nuk ka emër në listë pagesat që disponohen nga ky institucion, gjithashtu për vjetërsinë e kërkuar për subjektin Intersig sh.a nuk figurojnë në rajonin Shkodër.

b.4 Sipas të dhënave të grumbulluara, kandidatja {...}del të ketë përvojë profesionale deri në momentin e kandidimit si vijon: si juriste - 4 vjet e 8 muaj e 20 ditë; si lektore e së drejtës (me kohë të plotë) - 5 vjet e 10 muaj e 14 ditë; si specialiste e nivelit të mesëm në punësimin e fundit juriste e nivelit të lartë në administratën publike - 3 vjet e 7 muaj e 3 ditë. Në total, kandidatja ka përvojë profesionale me kohë të plotë si lektore e së drejtës dhe si juriste e nivelit të mesëm dhe

² *Koha kur ka filluar zbatimin i Ligjit nr. 7703, date 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit, për përfitim të mbrojtjes nga sigurimet shoqërore, organet e sigurimeve shoqërore grumbullonin dokumentacionin për veprimtaritë ekonomike të punësuarve dhe mblihdnin kontributet e paguara të sigurimeve shoqërore.*

në punësimin e fundit juriste e nivelit të lartë në administratën publike në total 14 vjet 2 muaj dhe 7 ditë.

c) pasja gradë shkencore në drejtësi.

c.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentin “Diplomë Doktorate” nr.1856 (Nr. i Regjistrimit të KVTA 3421 dhe Nr. i Regjistrimit UTFDRN000157), lëshuar më datë 24.09.2018, nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit “Znj. {...} fiton Gradë Shkencore “Doktor” në Civile/E drejtë Tregtare”.

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se:

“ ...

7. Gradë Shkencore “Doktor” në Civile/E drejtë Tregtare” e fituar nga znj. {...} figuron e regjistruar ne regjistrin e KVTA-së për Gradën Shkencore: “Doktor” me numër rendor: 3421, Universiteti i Tiranës, Nr. Vendimi: 216, datë 08.05.2018.

...

Të gjitha gradat shkencore të listuar më sipër, përveç gradës shkencore të fituar nga ..., i përkasin fushës së drejtësisë”.

ç) mbajtja e funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

ç.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 01.08.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se “nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

d) mbajtja e pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

d.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 01.08.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se “nuk kam mbajtur ... pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

d.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi/emërimi u kërkuan dhe morën të dhëna nga disa parti politike kryesore në vend. Konkretisht:

me Shkresën nr. 221 prot., datë 12.09.2019, Partia Socialiste e Shqipërisë informon se znj. {...} nuk ka qenë anëtare ose e zgjedhur në organet drejtuese të Partisë Socialiste të Shqipërisë;

me Shkresën nr. 152 prot., datë 20.10.2019, Partia Demokratike e Shqipërisë kërkoi të dhëna shtesë/më të plota për individualizimin e kandidatëve (atësi, amësi, ditëlindje, vendlindje), ndër ta edhe për znj. {...}, me qëllim dhënien e informacionit të kërkuar Nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, meqenëse, nga verifikimi i kryer, në Regjistrin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, me të dhënat e kandidatëve të përmendur në shkresë (atë të Këshillit), shfaqej më shumë se një person, por pa specifikuar në këtë rast ndonjë prej kandidatëve, në veçanti për kandidaten {...}; me Shkresën nr. 337/1 prot., datë 19.09.2019, Lëvizja Socialiste për Integrim informon, ndër të tjera, se znj. {...} nuk ka qenë anëtare e Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe as pjesë e organeve të saj drejtuese;

me Shkresën nr. 78 prot., datë 05.09.2019, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet informon, ndër të tjera, se znj. {...} nuk ka qenë anëtare apo pjesë e organeve drejtuese të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) që nga themelimi i saj.

d.3 Nga verifikimi i bërë, më datë 04.11.2019 nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), rezultoi se në këtë regjistër, me përbërës të gjendjes civile znj. {...} me shtetësi shqiptare.

d.4 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi u kërkua dhe u morë informacion nga gjykata e regjistrit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me Shkresën nr. 847/4 prot., datë 28.10.2019 sa i përket kandidates {...}, ka informuar se “nuk rezulton të ketë qenë pjesë e organeve drejtuese të Partive Politike.

III. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË

A. Për kriteret sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit

1. Disa nga kriteret e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Ligjin e Statusit, neni 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”.

1.1 Sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, “2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të nenit 28, të këtij ligji; ...”.

1.2 Ndërsa sipas nenit 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të Ligjit të Statusit, që parashikon kriteret e pranimit në formimin fillestar dhe bën pjesë në institutin e rekrutimit të kandidatëve magjistratë, “Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për

t'u pranuar në formimin fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; ...; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; ...; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

2. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikuan këto kriterë kandidimi/emërimi:

a) zotësia e plotë për të vepruar.

a.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi u mbajt në konsideratë se “zotësia për të vepruar”, si kategori juridike që i takon individit, gjen rregullim në legjislacionin civil (Kodin Civil), ndërsa i njëjti kuptim për të konsiderohet edhe kur individ është subjekt i të drejtës publike. Zotësia për të vepruar nënkupton aftësinë e personit për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Zotësia për të vepruar fitohet me arritjen e moshës 18 vjeç dhe, sipas ligjit, pasja e kësaj zotësie prezumohet deri në vërtetimin e heqjes apo kufizimit të saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

a.2 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidates, ajo del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë. Me Shkresën nr. 8407/2 prot., datë 25.10.2019 gjykata e vendbanimit të kandidates, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, informon se nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

a.3 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidates, ajo del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj në listën e personave të regjistruar si mos pasjes së zotësisë për të vepruar. Me Shkresën nr. 2659 prot., datë 30.10.2019, Dhoma Kombëtare e Noterisë, informon se nga verifikimi i bërë i listës së personave të cilëve ju është hequr zotësia për të vepruar rezulton se kandidatja Znj. {...} nuk figuron në atë listë.

b) shtetësia shqiptare.

b.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 15.02.2010, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, konkretisht “shqiptare”.

b.2 Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga Certifikata Elektronike Personale printuar në letër më datë 31.07.2019, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare.

c) gjendja gjyqësore.

c.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentin “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”, me nr. 11 prot., datë 31.07.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit kandidatja figuron e padënuar penalisht.

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore), e cila, me Shkresën nr. V-2595/1 prot., datë 09.08.2019, ndër të tjera, informon se nga verifikimi i bërë në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Gjyqësore, kandidatja rezulton e padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

ç) disiplina në punë.

ç.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 01.08.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se *“gjatë karrierës time profesionale nuk jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk kam marrë dhe as nuk kam asnjë masë disiplinore”*.

ç.2 Po ashtu, në rastin e aplikimit, siç u përmend edhe më lart, kandidatja ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, nga verifikimi i të cilës, në rubrikën “Shkaku i largimit nga puna”, nuk pasqyrohet në asnjë rast që kandidatja të jetë larguar nga puna për shkaqe disiplinore.

ç.3 Gjithashtu, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar; Vërtetim datë 16.07.2019, lëshuar nga Komisionerët Publikë” (punëdhënësi aktual), përmes të cilit vërtetohet se kandidatja punon si Këshilltare prej datës 01.02.2018 dhe se *“Që nga koha kur ka filluar punë ndaj znj. {...} nuk është marrë ndonjë masë disiplinore dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi”*. Vërtetim datë 10.07.2019 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përmes të cilit vërtetohet se kandidatja ka punuar si Juriste dhe pjese e grupit të hartimit e akteve nën ligjore të Kodit të ri të Doganave për periudhën 2015-2018 dhe se *“Që nga koha kur ka filluar punë deri në momentin e largimit me dëshirën e saj ndaj znj. {...} nuk është marrë ndonjë masë disiplinore dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi”*. Vërtetim datë 15.07.2019 lëshuar nga Instituti Francez i Menaxhimit De Gestion përmes të cilit vërtetohet se kandidatja ka mbuluar si pedagoge modulin e të drejtës tregtare për periudhën 2013-2014 si dhe 2014-2015. Vërtetim datë lëshuar nga Shoqëria Albamedia sh.p.k përmes të cilit vërtetohet se kandidatja ka punuar si Këshilluese ligjore për periudhën 2014-2015. Vërtetim datë 11.07.2019 lëshuar nga Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër përmes të cilit vërtetohet se kandidatja ka punuar si pedagoge me kohe te pjesshme për periudhën 2003-2004 dhe 2004-2005.

ç.4 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga të gjithë subjektet shtetërore dhe privatë, ku kandidatja ka punuar dhe punon aktualisht. Këto subjekte dhe informacione të përcjella nga ata janë evidentuar në paragrafin b.2, shkronja “b”, pika 3, Kreu II, të këtij relacioni. Konkretisht:

me Shkresën nr. 20155/1 prot., datë 18.10.2019, OSHEE informon se kandidatja “*gjatë ushtrimit të detyrës nuk rezulton që të ketë marrë masa disiplinore*”;

me Shkresën nr. 2752/1 prot., datë 22.08.2019, Universiteti Luigj Gurakuqi informon se kandidatja “*nuk është larguar nga puna për shkaqe disiplinore*”;

me Shkresën nr. 20340/1 prot., datë 15.08.2019, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë informon se për kandidaten “*nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore*”;

me Shkresën nr. 8 prot., datë 14.08.2019, Shoqëria Albmedia Sh.pk informon se për kandidaten “*nuk është marrë asnjë masë disiplinore*”;

me Shkresën nr. 433/1 prot., datë 09.08.2019, Komisionerët Publikë informojnë se kandidatja “*ndaj saj nuk është marrë ndonjë masë disiplinore dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi*”.

d) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990.

d.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 01.08.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*nuk kam qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*”.

d.2 Gjatë verifikimit, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 01.08.2019, kandidatja dorëzoi të plotësuar formularin e aplikimit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

dh) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

dh.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 01.08.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*nuk kam qenë dhe nuk jam bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete*”.

dh.2 Gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit edhe të kriterit të figurës së kandidates, u kërkua dhe u mor informacion nga organet ligjzbatuese, nga të cilat nuk u bë prezent ndonjë e dhënë për qenien e kandidates bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit

1. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49³ në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32⁴, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë së kandidatit, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 98/26 prot., datë 10.10.2019.

3. Pas njohjes së kandidates më këtë Raport dhe paraqitjes nga ajo të sqarimeve dhe dokumentacionin mbështetës, u kërkua raportim shtesë nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin më datë 31.10.2019 me shkresë nr. 3832/9 prot, pa ndryshuar përfundimet e saj.

4. Për verifikimin e kriterit të pasurisë së kandidates u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

4.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019,

³ “5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.

⁴ “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

4.2 Ndërsa nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 20339/1 prot., datë 26.08.2019.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit

1. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës së kandidates, u kërkua dhe u morën raportet përkatëse nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

IV. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI I REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u njoh me relacionin përkatës të relatorit të çështjes, si dhe materialet e grumbulluara gjatë verifikimit, marrë shkas nga gjetja e konstatuar nga relatori i çështjes në lidhje me një nga kushtet formale të kandidimit të znj. {...}, me vendim të ndërmjetëm, për racionalitet dhe efektivitet, vendosi të shqyrtonte paraprakisht rezultatet e verifikimit vetëm sa i përkiste kushteve dhe kriterëve formale të kandidimit dhe, në varësi të kësaj, nëse konkludohej për përmbushjen e tyre nga kandidatja, të vijonte shqyrtimi edhe për kriteret e pasurisë dhe të figurës.

2. Në lidhje me kushtet dhe kriteret formale të kandidimit të znj. {...}, pas shqyrtimit të rezultateve të verifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush ato, me përjashtim të një prej kushteve të kandidimit.

3. Konkretisht, gjatë procedurës së verifikimit është konstatuar si gjetje, që mund të pas sillte skualifikimin dhe përjashtimin e kandidates nga procedurat e emërimit ku ajo ka kandiduar, mosplotësimi nga ajo të kushtit të *“përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit për Statusin. Të dhënat konkrete të kandidates në lidhje me këtë kusht kandidimi janë evidentuar në shkronjën “b”, Kreu II, i këtij Vendimi.

4. Në përputhje me Vendimin 75/2019, më datë 23.09.2019, relatori i çështjes ka njoftuar kandidaten për gjetjen e procedurës së verifikimit, ndërsa ajo është ftuar për të dhënë shpjegime rreth gjetjes, sikundër edhe për të paraqitur dokumente mbështetës për pretendime të mundshme të saj, duke iu siguruar kështu kandidates e drejta për t’u dëgjuar në një procedurë administrative.

5. Më datë 27.09.2019, znj. {...} ka dorëzuar parashtrimet, qëndrimet dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjen në procedurën e verifikimit si me poshtë:

Omissis..... Në vijim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit tim për gjyqtare në Gjykatën e Lartë, me e-mailin e datës 23.09.2019, jam njoftuar nga ana e

relatorit të çështjes për gjetjen ..., si dhe sqarimet lidhur me mungesën e kontributeve shoqërorë të dërguar në shkresat e ISSH^{se} bashkëlidhur e-mailit në funksion dhe të informacionit të referuar nga shkresa nr.4168/Prot., datë 14.08.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

1. Lidhur me gjetjen....

1.2 Ashtu sikurse, Ju është deklaruar nga ana ime dhe siç rezulton nga dokumenti i vënë në dispozicion librezë e punës e noterizuar në të cilën janë shënimet e punëdhënësve mbi periudhën e punësimit, rezulton se kam qenë e punësuar si pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti “Kristal”, ku nga data 01 tetor 2013 deri më 15 shtator 2014 kam mbajtur pozicionin e përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Penale, pra në total e punësuar për **rreth 6 vite**. Punësimi im gjatë kësaj periudhë ka qenë aktiv me kohë të plotë dhe për këtë periudhë janë paguar nga punëdhënësi të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore, deri në mbylljen e këtij Universiteti me VKM nr.539 datë 06.08.2014.....

1.3 Sa më sipër, rezulton e provuar me dokumentacion ligjor se gjatë punësimit tim pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universiteti “Kristal” kam pasur përvojë profesionale aktive në fushën e mësimdhënies për një periudhë të siguruar prej 5 vite e 11 muaj. Lidhur me gjetjen e njoftuar në e-mailin e datës 23.09.2019, çmuj se jam në plotësim të kriterit ligjor të parashikuar nga neni 49 ...

1.4 Mesa kuptoj, verifikimi mbi këtë eksperiencë punësimi duhet t’i jetë referuar të dhënave në CV-në time të dorëzuar si pjesë e dokumentacionit të kërkuar në funksion të aplikimit tim. Më lejoni të sqaroj se eksperiencia në këtë periudhë ka qenë e rëndësishme, ndaj dhe është shënuar në CV, pasi kanë qenë vitet kur kam qenë e sapo diplomuar, **por nuk është paraqitur nga ana ime si eksperiencë pune në shërbim të përvojës 15 vjeçare të kërkuar, për pozicionin për të cilin kam aplikuar.....**

1.5 Lidhur me faktimin e kësaj përvoje në fushën akademike dhe për të provuar marrëdhënien e punësimit, në aplikimin e paraqitur kam vënë në dispozicion shkresën nr.2424 prot., të Univ. Shkodrës., datë 11.07.2019, përmes së cilës vërtetohet se kam qenë e aktivizuar si pedagoge me kohë të pjesshme pranë Fakultetit të Drejtësisë të këtij Universiteti, gjatë viteve akademike 2003-2004 dhe 2004-2005.

Lidhur me mungesën e pagesës së sigurimeve shoqërorë që mbulon këtë periudhë, ju lutem gjeni bashkëlidhur vërtetimin nr. 3186 prot., datë 26.09.2018, të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në plotësim të vërtetimit të lëshuar nga ky Universitet dhe të dorëzuar nga ana ime në funksion të aplikimit tim, vërtetim në të cilin është ri konfirmuar periudha ime e punësimit si dhe saktësuar lloji i marrëdhënies së punësimit në raport me ndalimin e tatimit në burim mbi honorarët e marra.....

Sa më sipër, sqaroj se marrëdhëniet e mia të punësimit kanë filluar që kur jam punësuar si pedagoge e jashtme pranë Univ. Shkodrës, Fakulteti i Drejtësisë, dhe vazhdojnë deri më sot në datën e dorëzimit të këtyre parashtrimeve, mbi 15 vjet përvojë profesionale e ndërthurur sa në fushën akademike ashtu dhe në sektorin privat dhe në administratë publike, në të gjitha llojet e veprimtarive të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 3 e nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në të gjitha rastet marrëdhënia ime e punësimit dhe përvoja ime në këto drejtime dhe në të gjitha institucionet ku kam qenë e punësuar është vërtetuar me dokumentacionin përkatës ligjor, si librezat e punës, pagesat e kontributeve të

sigurimeve shoqërore apo nga vërtetime zyrtare të lëshuara nga subjektet/ punëdhënës, mbi periudhën e punësimit pranë tyre dhe mbi objektin e punës që kam kryer.....Omissis..

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor duke u mbështetur në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, vlerëson se kandidatja {...} duhet të s'kualifikohet dhe përjashtohet nga procedurat e emërimit për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë ku ajo ka kandiduar. Në këtë konkluzion Këshilli arrin në vlerësim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, frymës dhe qëllimit të ligjbërësit në lidhje me përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur. Kushtet e kandidimit për gjyqtar të Gjykatës së Lartë të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe akteve ligjore të nxjerra në zbatim të saj, të cituara më lart, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për t'u vlerësuar dhe renditur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për vendet vakante në Gjykatën e Lartë. Nëse kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore kjo do të shërbente si shkak ligjor për skualifikimin e tij pa vijuar më tej me verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve të tjera.

7. Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese dhe ligjore të posaçme, ***lex specialis***, rezulton se ligji material ka përçarur qëllimin e kushtetutbërësit për transformimin e Gjykatës së Lartë “*në një gjykatë karriere përmes vendosjes së kritereve transparente për emërimin e gjyqtarëve nga të dy kategoritë (gjyqtar dhe jogjyqtar/juristë të spikatur)*” për të garantuar një përbërje cilësore, jo vetëm nga pikëpamja profesionale, por në veçanti edhe sa i përket integritetit dhe figurës. Përmes vendosjes së kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë synohet identifikimi dhe përzgjedhja e profesionisteve në fushën e drejtësisë, të cilët të kenë **aftësi të spikatura** sipas kategorive të saj, por njëherazi edhe një integritet të lartë moral, sepse suksesi i vërtetë i çdo gjykate, në veçanti i Gjykatës së Lartë, si organi më i lartë i pushtetit gjyqësor, varet nga kompetenca profesionale dhe integriteti moral i çdo gjyqtari, si ushtrues të drejtpërdrejtë të pushtetit gjyqësor në funksion të dhënies së drejtësisë në raste individuale dhe veçanërisht për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit me qëllim për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

8. Nga të dhënat e rezultuara nga aktet e administruara gjatë procedurës së verifikimit rezulton se kandidatja znj. {...} nuk plotëson kushtin e ***përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.***

9. Një përfundim i tillë arrihet nga analiza e akteve të administruara, të tilla si : jetëshkrimi i kandidatës; librezat e punës dhe konfirmimet e marra nga organet e administratës publike, ato të tatimeve, të sigurimeve shoqërore apo edhe nga subjektet punëdhënës të kandidatës; nga të cilat rezulton se kandidatja ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në Korrik 2003 dhe ka përvojë profesionale të përgjithshme si vijon:

“**Juriste**” në KESH sh.a, Divizioni Shkodër, për periudhën 15.03.2004 - 05.12.2008;

“**Pedagoge**” në Universitetin Jopublik “Kristal”, për periudhën 01.11.2009 - 30.09.2013;

“**Përgjegjëse departamenti**” në Universitetin Jopublik “Kristal”, për periudhën 01.10.2013 - 15.09.2014;

“**Specialiste**” në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për periudhën 06.01.2016 -01.02.2018;

“Këshilltare Ligjore” në Institucionin e Komisionerëve Publik, për periudhën 01.02.2018 e në vijim.

9.1 Nga një mbledhje matematikore e periudhave të punësimit si më lart rezulton se kandidatja ka ketë përvojë profesionale të konfirmuar si vijon:

- si juriste - 4 vjet e 8 muaj e 20 ditë;
- si lektore e së drejtës (me kohë të plotë) - 5 vjet e 10 muaj e 14 ditë;
- si juriste e nivelit të lartë në administratën publike - 3 vjet e 7 muaj e 3 ditë.

9.2 Në momentin e kandidimit, kandidatja znj. {...} ka përvojë profesionale të përgjithshme me kohë të plotë në total prej 14 vjet 2 muaj dhe 7 ditë. Në këtë kuadër kandidatja nuk përmbush kushtin ligjor të kandidimit të përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit për Statusin.

10. Dhe nëse vlerësimi i këtij kushti kandidimi vijon më tej, pikërisht sa i përket përvojës profesionale të veçantë, pra si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, rezulton qartazi se kandidatja znj. {...} nuk mund të plotësojë kushtin e kandidimit të jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale të veçantë. Për këtë mjafton të përmendet se përvoja e kandidatës si “Juriste” në KESH sh.a, Divizioni Shkodër, prej 4 vjet e 8 muaj e 20 ditë (15.03.2004 - 05.12.2008), nuk mund të klasifikohet si përvojë profesionale e veçantë, pra si **“jurist i nivelit të lartë”**.

11. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuar në fakt pretendimin e kandidatës {...} . Kjo e fundit në mënyrë të përsëritur ka pretenduar se : *“Omissis.....Përvoja e referuar nga ana Juaj i është referuar eksperiencës time profesionale vetëm me kohë të plotë, dhe ndaj referimi si përvojë vetëm 14 vite e dy muaj, mund të krijojë një panoramë jo të qartë për anëtarët e KLGJ mbi eksperiencën time. Konstatoj qe në këtë përllogaritje nuk është përfshire si dhe nuk është referuar eksperiencia ime si pedagoge me kohë të pjesshme për periudhat 2003-2004 dhe 2004-2005, sipas viteve akademike të sipër cituar si dhe angazhimi pranë shoqërisë Albamedia Sh.p.k për një periudhë kohore duke filluar nga 2014-2015 si këshilluese dhe asistente ligjore. Të dy këto eksperiencia pune dhe përvoja janë pjesë e rëndësishme e përvojës time si dhe janë dokumentuar nga ana ime me Shkresën nr. 1221/1 prot., datë 28.08.2019, Universiteti i Politeknik i Tiranës, si dhe me Shkresën, nr. 8 prot., datë 14.08.2019, të Shoqërisë Albamedia Sh.p.k . Të dy këto eksperiencia, për më tepër , kanë qenë pjesë e verifikimit nga ana Juaj në drejtim të konstatimit të ekzistencës ose jo të masave disiplinore apo dhe verifikimit të rrethanave të paraqitura mbi marrëdhënien e punësimit...omissis.. gjatë vitit akademik 2013- 2014, si dhe gjatë vitit akademik 2014-2015, kam qenë e aktivizuar si pedagoge me kohë të pjesshme në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Masterin e delokalizuar të Universitetit të Bordosë, në fushën e “Menaxhimit të ndërmarrjeve”. Vlerësoj të sqaroj, në funksion dhe të përvojës si lektore gjatë këtyre viteve se moduli i së drejtës tregtare, ka qenë moduli i vetëm në gjuhën shqipe, pasi pjesa tjetër e lëndëve kanë qenë në Frëngjisht dhe studentët ishin kryesisht të diplomuar jashtë Shqipërisë dhe të gjithë frëngjisht folës. Ka qenë ndër përvojat e mia më të mira profesionale në fushën akademike, ku janë diplomuar dy breza studentësh të shkëlqyer që punonin në institucione me emër si Deloitte, Banka e Shqipërisë, Albtelecom sh.a etj. Po ashtu, gjatë këtij viti 2014-2015, kam qenë e aktivizuar pranë shoqërisë Albamedia sh.p.k. në cilësinë e ekspertit të jashtëm, duke mbuluar sektorë të ndryshëm*

në përshtatje me nevojat e biznesit, gjithmonë e aktivizuar në përvoja të lidhura me fushën tregtare, objekt dhe i tezës time të doktoratës, deri në momentin kur jam aktivizuar me kohë të plotë në dhjetor 2015 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave...Omissis”.

12. Bazuar në gjetjet e sipërcituar Këshilli konkludon se pretendimet e përsëritura të kandidatës nuk janë të bazuar në ligj dhe në prova. Nga analiza e provave shkresore rezulton e provuar se kandidatja {...} nuk ka ushtruar minimalisht 15 vjet veprimtari profesionale në veprimtarinë e përcaktuar në nenin 136 pika 3 e Kushtetutës. Në kushtet kur kandidatja është diplomuar në korrik të vitit 2003 në Fakultetin Juridik “Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër”, me shkëputje nga puna është e mjaftueshme evidentimi i saj që në fillim të vitit 2003 - 2004 dhe 2004-2005 ka qenë konsulente e jashtme ligjore /juriste për Shoqërinë e Sigurimit “Intersig” sh.a dega Shkodër dhe Shoqërinë AlbMedia sh.p.k si edhe deri në vitin 2008 juriste pranë Korporatës Energjetike Shqiptare sh.a, Divizioni Shkodër për ta bërë numerikisht të pamundur arritjen e një përvoje profesionale prej 15 vitesh në kategorinë e profesioneve të përcaktuara nga dispozita Kushtetuese për kandidatin jo gjyqtar të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu aktet e administruara provojnë se një pjesë e veprimtarisë profesionale e pretenduar se është ushtruar nga kandidatja nuk kanë konfirmim jo vetëm nga librezat e punës por edhe nga administrata publike fiskale.

I. KONKLUZIONE

1. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidatja znj. {...} nuk plotëson një prej kushteve të kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të *“përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë ku ajo ka konkurruar.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret nuk është e nevojshme shqyrtimi i rezultateve të verifikimit në lidhje me plotësimin ose jo nga kandidatja të kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, pikërisht të pasurisë dhe të figurës, përse kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti ose kriteri të vetëm kandidimi pasjellë skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136, pika 3 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “e”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidatës jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtarë në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, si dhe Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR